


Ushqimet që duhen provuar

"Ky vend është i ngrohtë dhe pjellor, sepse është plot me ullishte dhe vreshta të mira."

Straboni, historian i vjetër grek, duke përshkruar Ilirinë


Gatimet dhe guidat e degustimit të verës, rakisë e vajit të ullirit janë një tjetër përvojë unike që nuk duhet humbur gjatë vizitës suaj në qytetin e Beratit. Pozita gjeografike, kushtet natyrore dhe klima e butë mesdhetare e bëjnë Beratin një rajon të pasur me shumëllojshmëri prodhimesh bujqësore si ullin, fiq, qershi e jo vetëm. Prodhimet blegtorale dallojnë gjithashtu Beratin për mishin e shijshëm e djathrat origjinalë. Kantinat e verës përpunojnë varietetet e shumta të rrushit lokal dhe ofrojnë ture degustimi të verërave apo rakisë me nje aromë unike. Një tjetër pasuri e Beratit janë dhe ullinj të shijshëm e vaji i ullirit që prodhohet ndër shekuj. Një shishe raki, verë apo vaj ulliri do të ishte dhurata ideale që mund t'i bënit dikujt nga qyteti i një mbi një dritareve.



Eventet që nuk duhen humbur

Në cilëndo periudhë ta vizitoni Beratin, gjithnjë do t'ju ofrohet një event për mos t'u humbur. Aktivitetet dhe ngjarjet e ndryshme, gjithnjë e më të shpeshta, jo vetëm që gjallërojnë qytetin, por po shndërrohen edhe në një traditë të përvitshme.

- Muzikë, argëtim dhe aktivitete sportive. Në maj një tjetër event, Xixëllonja Fest do të bëjë së bashku të gjithë të apasionuarit pas natyrës në Mbreshtan.
- Në qershor, turistët mund të shijojnë varietete të ndryshme të qershive dhe gatime të tjera tradicionale gjatë Festivalit të Qershive, por edhe të njihen me dimensionet e ndryshme të artit e copëza të performuara nga fëmijë të talentuar gjatë Festivalit Mbarëkombëtar të Teatrit për Fëmijë.
- Në shtator, turistët mund të përjetojnë procesin e vjeljes së fiqve gjatë Festivalit të Roshnikut.
- Gjatë eventit mbarëkombëtar treditör Berati Wine Fest në tetor, gjithëkush do të ketë mundësinë të vizitojë vreshtat, të takojë nga afër prodhuesit lokalë për të njohur më mirë produktin vendas teksa shijon varietetet e ndryshme të verës vendase.
- Në nëntor të gjithë të pasionuarit pas natyrës e sporteve do të mund ta gjejnë veten pjesë të Maratonës së Gjelbër, një event dyditor që promovon natyrën dhe hapësirat rurale rreth e përfaqë Beratit.
- Mbrëmjet e dhjetorit gjithashtu rezervojnë argëtim e festë për të gjithë vizitorët. Përgjatë gjithë muajit organizohen evente që ndriçojnë e gjallërojnë edhe më shumë qytetin. Mangalem's Shades, një event shumëngjyrësh, do të ndriçojë si asnjëherë më parë fasadat e bardha të lagjes Mangalem. Një festë, ku të gjithë janë të ftuar.



Më skano
për të zbuluar më shumë rreth Beratit
www.berat.al

Zyra e Informacionit Turistik

Në Qendrën e Informacionit Turistik që ndodhet në sheshin qendror të Beratit "Teodor Muzaka", mund të merrni informacione për qytetin dhe atraksionet e tij, harta, materiale të ndryshme informacioni dhe botime për t'ju ndihmuar të shijoni vizitën tuaj në qytetin e Beratit.

Përveç të tjerave, në Qendrën e Informacionit Turistik mund të merrni informacion mbi eventet dhe aktivitete që zhvillohen në Berat, mbi guidat turistike në qytet dhe rrethinat e tij etj.
Orari i hapjes: E hënë - E dielë, 8:00 - 16:00



Financuar nga:



Implementuar nga:



Historitë
e pafundme
të një mbi një
dritareve



10 gjërat që duhen bërë në Berat

1. Udhëtoni në kohë duke vizituar lagjet historike të Beratit

Mangalem, Goricë dhe Kala, arkitektura e të cilave daton që nga periudha osmane e shekujve XVIII e XIX, e kanë bërë Beratit, pjesë të Listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO në vitin 2008. Fasadat e bardha të shtëpive me dritaret e panumërta, vendosur mbi dy kodra buzë lumit Osum dhe brenda mureve të kalasë, rrugicat e shtruara me kalldrëm, të banuara prej shekujsh, do jenë një "udhëtim në kohë" e një përvojë unike për çdo turist.

2. Vizitoni muzetë historikë dhe të artit

Muzeu Kombëtar Ikonografik Onufri dhe Muzeu Etnografik prej vitesh vizitohen nga mijëra turistë. Koleksioni i pasur i veprave mesjetare, përfshirë ato artistike e fetare, daton nga shekulli XIV deri në shekullin XIX dhe karakterizohet nga elementë mbresëlënës të mjeshtërisë. Ndërkaq, koleksioni prej 1400 artefaktesh i Muzeut Etnografik, paraqet me vërtetësi stilin e jetesës në qytetin e Beratit ndër shekuj.

3. Vizitoni tre kishat Bizantine

Tre kishat Bizantine të shekujve XVIII-XIX, Shën Mëri Vllaherna, Shën Triadha dhe Shën Mëhilli përfaqësojnë një rast të pashembullt në territorin e Shqipërisë. Vizitorët do të dëshmojnë jo vetëm rëndësinë fetare të qytetit të Beratit në periudhën e Mesjetës, por dhe mjeshtërinë në fushën e ndërtimit, zhvillimin e lartë arkitektonik dhe nivelin e jashtëzakonshëm artistik të afreskeve.

4. Njihuni me trashëgiminë Islame të Beratit

Xhamitë e Beratit janë pasuri e trashëgimisë së historisë së Islamit, jo vetëm në Berat, por edhe në rajon. Xhamia e Kuqe dhe ajo e Bardhë (shek. XV) brenda territorit të Kalasë, Xhamia Mbret (shek. XV), Xhamia e Plumbit (shek. XVI), Xhamia e Beqarëve (shek. XIX) dhe Teqeja e Helvetive (shek. XVIII), mbartin vlera të jashtëzakonshme të kulturës, artit e arkitekturës së Beratit.

5. Përshkoni urën e Goricës për një panoramë 360° të qytetit

Ura e Goricës e ndërtuar në fund të shekullit XVIII është një nga monumentet simbol të Beratit. Përshkrimi i saj do ju përshfaqë përpara syve një peizazh mahnitës të Beratit, i cili në çdo moment të ditës ofron një panoramë piktoreske 360° të qytetit.

6. Mësoni më shumë rreth tolerancës fetare duke vizituar vendet e shumta të kultit

Ky itinerar ju ofron mundësinë të vizitoni dhjetra kisha, xhami e teqe që ndodhen jo vetëm në hapësirën urbane të Beratit, por edhe në atë rurale. Kishat e periudhës pasbizantine si Shën Spiridhoni, Shën Ilia, Shën Kolli, Shën Kostandini dhe Shën Elena, apo objektet e kultit islam si Xhamia Mbret, Xhamia e Beqarëve, Xhamia e Plumbit, Teqeja e Helvetive, përçojnë më së miri mesazhin e tolerancës e bashkëjetesës fetare në harmoni të plotë mes të krishterëve e myslimanëve ndër shekuj.

Qyteti i një mbi një dritareve

7. Bëni një udhëtim të shkurtër në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorit"

Parku Kombëtar "Mali i Tomorit" me sipërfaqe prej 4000ha, me florë e faunë të pasur, ofron mundësi për eksplorim e sporte në natyrë si hiking, trekking e kamping. Ngjitja e malit të Tomorit, 2416m i lartë, është një nga përvojat më mbresëlënëse për adhuruesit e natyrës. Prej shekujsh, ai konsiderohet si një mal i shenjtë dhe çdo vit në muajin gusht zhvillohet një pelegrinazh masiv nga besimtarët bektashi, duke e bërë një nga festat fetare më të njohura në vend e përtej kufijve.

8. Shijoni panoramën më piktoreske të qytetit nga kulla e Tabjes

Kulla në pikën më jugore të kalasë e quajtur nga vendasit si Tabja është vendi më panoramik mbi qytetin e Beratit. Është vendi i duhur për të shkrepur foton ideale me qytetin "në pëllëmbë të dorës". Përmes një teleskopi binokular mund të shihni qytetin edhe më në detaj.

9. Rrisni adrenalinën duke bërë rafting në Kanionin e Osumit

Lugina e Osumit ofron mundësi të panumërta për të eksploruar monumentet e natyrës si kanioni i Osumit dhe ujvara e Bogovës. Rafting në Kanionin e Osumit është prej vitesh një nga aktivitetet më emocionuese sportive dhe pjesë e çdo turi për turistët aventurierë. Nëse jeni në kërkim të një përvoje me shumë adrenalinë, ky është aktiviteti që nuk duhet të humbisni.

10. Zhytuni në gjelbërimin e natyrës

Hapësirat rurale të Beratit ofrojnë mundësi të shumta për ekoturizëm, për të gjithë vizitorët që duan të shijojnë natyrën dhe traditat mikpritëse të këtyre zonave. Roshniku, Sinja, Lapardhaja e Droboniku janë shndërruar tashmë në destinacione që presin vizitorë vendas e të huaj.

